



Datë: 17.11.2025
Numër Protokolli: 7494/2025

A.nr.1124/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1124/2025, të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesi N.Sh kundër organit të punësimit: Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1124/2025, e datës 12.06.2025, e parashtruar nga ankuesi, N.Sh, në atë mënyrë që *aprovohet* pretendimi ankimor lidhur me vlerësim jo të drejtë të Jetëshkrimit/CV-së në intervistën më gojë, ndërsa, *refuzohen* si të pabazuara pretendimet tjera si në ankesë.
- II. Ndryshohet** Njoftimi i datës 28.05.2025, i Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimi më numër të referencës RN00016866, ashtu që, pikët e ankuesit lidhur me intervistën më gojë ndryshohen nga 19.4 pikë në 20.8 pikë, ku pikët e përgjithshme të ankuesit nga 80 pikë, ndryshohen në 81.2 pikë.
- III. Obligohet** Departamenti për Politika të Personelit dhe Rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, që brenda fatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi sikurse përcaktohet në pikën II të dispozitivit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet më shkrim lidhur më zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi N.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 12.06.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016866, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar, të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3958/2025, të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës, 12.06.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë 18.06.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Përgjigjen në ankesë të datës 24.06.2025, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00016866, të datës 28.02.2025; Formulari i përshkrimit të punës; Vendim i datës 29.04.2025; Vendimi i KPMSHCK-së i datës, 27.08.2024, me numër protokolli 4461/2024, dhe A.nr.1035/2024; Vendim për emërimin e komisionit, me numër protokolli Nr.2145, të datës 07.04.2025; Akt emërimi i datës 17.10.2019; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit, me numër protokolli Nr.1947, të datës 10.06.2019; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit me numër protokolli Nr.1930, të datës 10.06.2019; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit me numër protokolli Nr.1960, të datës 11.06.2019; Akt emërimi i datës 13.03.2020; Lista e aplikantëve (aprovuar dhe refuzuar); Vendim me numër Ref.DBN-MM5/3/8/2025, i datës 14.04.2025; Vendim i datës 29.04.2025; Njoftim për test me shkrim, të datës 08.05.2025; Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit; Njoftim i datës 16.05.2025; Njoftim i kandidatëve për intervistë i datës 26.05.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatët në intervistë, të datës 28.05.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve, e datës 28.05.2025; Njoftim për rezultatet përfundimtare, të datës 28.05.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 11.03.2025, të kandidatës R.S.S, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 26.03.2025, të kandidatit N.SH, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Vendimin me numër protokolli 5125/2025 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është pjesërisht e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Mbrojtjes më datë 28.02.2025, ka shpallë konkursin publik për pranim me numër reference RN00016866, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës Zyrtar për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar në Departamentin për Menaxhimin e Dokumenteve, klasa e pozitës Profesional 2, një (1) vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 01.03.2025 deri më datën 30.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe se i njëjti ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke iu nënshtruar vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim duke grumbulluar 60.6 pikë, ndërsa, në intervistën më gojë 19.4 pikë, në total 80 pikë, mirëpo, sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit të datës 28.05.2025, ankuesi është renditur si kandidati i tretë me më shumë pikë të arritura, rrjedhimisht, si kandidate me më shumë pikë rrjedhë të jetë R.S-S, më gjithsej 92.22 pikë (64.6 pikë në testin me shkrim dhe 27.62 pikë në intervistën më gojë), ashtu që, edhe e njëjta është shpallur edhe kandidate fituese.

Ankuesi pas publikimit të njoftimit përfundimtar të vlerësimit brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016866, mbi pretendimin ankimor se nuk është vlerëuar drejtë CV-ja, ashtu që nuk janë marrë parasysh përvojat dhe aftësitë profesionale, ndërsa, në testin me shkrim nuk është vlerësuar drejtë dhe saktë nga komisioni vlerësues, konkretisht tek pjesa e eses, pasi që është vlerësuar vetëm me 10.6 pikë, gjë që sipas ankuesit është vlerësim i padrejtë. Shton se ekziston një konflikt i mundshëm i interesit ndërmjet komisionit të vlerësimit dhe kandidatës fituese pasi që e njëjta aktualisht është e punësuar në staf politik në Kabinetin e Ministrit. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj konkursin përkatës në tërësi.

Kolegji i Këshilli në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit me Nr.reference: RN0001686. Në këtë kontekst, fillimisht Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar*: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). *Arsim i lartë i paspecifikuar*: *Përvoja e punës e kërkuar*: Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale.

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 9: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përgjashtimisht, për pozita specifike të zyrtarëve/publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrit/përgjegjësit për administratë publike.*

-Nenit 44 :1. *Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësi përgjegjëse, në SIMBNj-së, në uebfaqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidatëve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë.*

-Nenit 45: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë. 3. Komisioni i pranimit zgjidhet adhoc për çdo pozitë nga lista e kandidateve/ë

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen administrative në procedurë ankimore, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, më konkretisht:

- Nenin 7: Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidateve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tri (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

-Nenin 8: Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.

- Neni 9: Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidateve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidateve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNj. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidateve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Nenin 10: Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidateve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidateve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses

testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë të lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

-Nenin 11: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor si me sipër, Kolegji shqyrtoi pretendimet ankimore në ndërlidhje me provat materiale të çështjes, ku vlerësoj së kriteret e përgjithshme formale për pozitën e kontestuar kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil. Kurse, Komisioni i Pranimi i themeluar sipas Vendimit nr.protokollit 2145, të datës 07.04.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrotjtjes, ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore sipas nenit 40, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publik.

Lidhur me pretendimet ankimore për vlerësim jo të drejtë në testin me shkrim, Kolegji ka gjetur së procedura e testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9, paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht, testi ka përmbajtur 25 pyetje me përgjigje të tipit shumë opsione dhe një pyetje në formë të eseja. Rrjedhimisht, ankuesi ka dhënë 25 përgjigje të sakta duke arritur 50 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më nga dy pikë), vlerësim ky që behët nga sistemi elektronik, ndërsa, në ese si vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimi, ankuesi është vlerësuar më 10.5 pikë, nga 20 pikët maksimale, duke arritur gjithsej 60.6 pikë. Pra, mbi këto rrethana nuk mund të vërehet vlerësim jo i drejtë i ankuesit, e që do të cenonte mundësitë e mos pjesëmarrjes së mëtejme në procedurën e kontestuar. Gjegjësisht, ankuesi ka akumuluar numër të nevojshëm të pikëve të vlerësimit për të vijuar me fazën e intervistimit më gojë.

Referuar pretendimit ankimor për vlerësim jo të drejtë të CV-së së ankuesit në intervistën me gojë, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e ankuesit të dorëzuar më rastin e aplikimit dhe si pasojë e analizimit ka konstatuar se ankuesi posedon Diplomën Nr.189/0513, të datës 27.05.2013, të lëshuar nga Kolegji "Fam", për përfundimin e studimeve themelore më datë 11.01.2013, në Programin Shkenca Politike dhe Administratë Publike, ndërsa, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit i njëjti ka

bashkangjitur Vërtetimin e datës 02.07.2019, të lëshuar nga Ud. Drejtor i Departamentit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes, më të cilin vërtetohet se ka qenë në marrëdhënie pune si Zyrtar i Kabinetit të Ministrit, nga data 29.09.2017 deri më 06.05.2019; Vërtetimin e datës 10.08.2019 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Politikat e Personelit dhe Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes, me të cilin vërtetohet se ka qenë në marrëdhënie pune në Ministrinë e Mbrojtjes sipas kontratës për shërbime të veçanta si Zyrtar për Çështjet e Kompensimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nga data 02.09.2019 deri më 23.06.2020; Referencën e datës 07.10.2024, të lëshuar nga Drejtori Menaxhues i HIB Petrol SHPK, me të cilin vërtetohet se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Punëtor Administrativ në HIB Petrol SHPK, nga data 15.10.2022 dhe vazhdon tutje, përvojë të cilën e ka shoqëruar edhe më dëshmi nga Trusti Pensional. Në fakt, në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore lidhur me çështje, Kolegji ka trajtuar edhe dokumentacionin e kandidatës fituese ku dhe ka vërtetuar se e njëjta posedon Diplomën me numër Nr.1677, të lëshuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, për përfundimin e studimeve themelore më datë 12.09.2017, në Programin Bankë Financë. Ndërsa, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit e njëjta ka bashkangjitur Akt emërimit me numër protokolli AE.Nr.5/463/2023 të datës 17.08.2023, me të cilin dëshmohet se e njëjta më datë 17.08.2023, ka themeluar marrëdhënia punë në Ministrinë e Mbrojtjes, në pozitën e punës Zyrtare Ekzekutive e Kabinetit të Ministrit ku dhe vazhdon tutje. Kandidatja ka deklaruar edhe përvojë tjetër në sektorin jo publik, por që kjo përvojë nuk ishte e shoqëruar më dëshmi nga Trusti Pensional apo Administrata Tatimore.

Rrjedhimisht, Kolegji nga analizimi formularëve të vlerësimit të ankuesit dhe kandidatës ka gjetur vlerësim jo të drejtë dhe jo të barabartë të ankuesit në raport me kandidaten fituese, rrjedhimisht, ankuesi ishte vlerësuar nga anëtarët të Komisionit të Pranimi sipas rrjedhës: Arsimi: 2, 2, 3, 3, 2; përvoja relevante në punë 3, 2, 3, 2, 2 dhe trajnimet 2, 2, 2, 2, 1. Ndërsa, ankuesja, ishte vlerësuar sipas rrjedhës: Arsimi 3, 3, 3, 3, 3, përvoja relevante në punë 4, 3.5, 3, 3, 3, trajnimet 2, 3, 3, 3, 3. Në vlerësimin e Kolegjit, ankuesi lidhur me kriterin e arsimit duhej të vlerësohej në mënyrë të barabartë me kandidaten fituese, pra më notën 3 nga çdo anëtar i Komisionit të Pranimi, ndërsa, lidhur me përvojën relevante në punë, po në vlerësimin e Kolegjit ankuesi është nënvlerësuar në raport me kandidaten fituese për faktin se ankuesi ka përvojë të ngjashme me kandidaten fituese si zyrtar në kabinetin e ministrit, dhe për më tepër ankuesi posedon edhe përvojë tjetër si Zyrtar për Çështjet e Kompensimit dhe Zyrtar administrativ, kështu që, ankuesi duhej të vlerësohej më 3 pikë nga çdo anëtar i komisionit. Ndërsa, lidhur me trajnimet, Kolegji nuk verën vlerësim jo të drejtë, pasi që ankuesi nuk ka trajnime relevante. Pra, mbi gjendjen e fakteve si më lartë, rrjedh se pretendimi ankimor lidhur me vlerësimin e CV-së/jetëshkrimit është i bazuar, kështu që, mbi këto rrethana ndryshohen pikët e vlerësimit të ankuesit nga 19.4 pikë në 20.6 pikë, në total numri i pikëve për ankuesin është 81.2 pikë, ashtu që, ankuesi mbetet kandidati i tretë me pikë t arritura.

Lidhur me pretendimin ankimor për konflikt interesi të kandidatës fituese në raport me anëtarët e komisionit të vlerësimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankuesi lidhur me këtë pretendim ka deklaruar pretendime të përgjithësuara, duke aluduar vetëm në faktin se kandidatja e shpallur fituese është e punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes dhe se i njëjti me asnjë dëshmi nuk ka vërtetuar se për shkak të këtyre dyshimeve për konfliktin të mundshme të interesit të ketë parashtruar kërkesë për përjashtim të anëtarëve të Komisionit të Pranimi ashtu siç përshihet me nenin 30, paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Referuar pretendimit ankimor së kandidatja R.S nuk ka përvojën e kërkuar pasi që mu për këtë fakt Këshilli me Vendimin nr.2583 të datës 03.09.2024, kishte anuluar të njëjtin konkursin pikërisht për shkak të mungesës së përvojës adekuate të kandidatës në fjalë, Kolegji ka analizuara dokumentacionin e aplikimit të kandidatës R.S (dokumentet të dorëzuara së bashku me përgjigjen në ankesë) në kuptim të plotësimit të kriterëve të përgjithshme formale, nga dhe ka konstatuar se e njëjta posedon: Diplomën me

numër Nr.1677, të lëshuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, për përfundimin e studimeve themelore më datë 12.09.2017, në Programin Bankë Financë, duke marrë titullin Bachelor në Banka dhe Financa, gradë e njohur sipas Vendimit ref.nr.2/6/3630, të datës 19.02.2020 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ndërsa, përkitazi më përvojën e punës pas diplomimit e njëjta ka bashkangjitur Akt emërimit me numër protokolli AE.Nr.5/463/2023 të datës 17.08.2023, me të cilin dëshmohet se e njëjta më datë 17.08.2023 ka themeluar marrëdhënia punë në Ministrinë e Mbrojtjes, në pozitën e punës “Zyrtare ekzekutive e Kabinetit të Ministrit ku dhe vazhdon tutje. Kandidatja ka deklaruar edhe përvojë tjetër në sektorin jo publik, por për Këshillin nuk ishin relevante pasi përvoja në Ministrinë e Mbrojtës është mbi 1 vit, duke përmbushur kështu kriterin e përvojës 1 vjeçare, dhe se kjo përvojë (në institucione jo publike) nuk ishte e shoqëruar më dëshmi nga Trusti Pensional apo Administrata Tatimore, fakt ky i konfirmuar më Vendimin e Këshillit A.nr.1035/2024, të datës 27.08.2024. Andaj, nisur kjo gjendje e fakteve rezulton se kandidatja R.S ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkurs, e duke qenë së ka arritur numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, e njëjta konsiderohet edhe si kandidate e suksesshëm për këtë procedurë të pranimit, kështu që, mbi këto rrethana, rrjedhë së njësia përgjegjëse në këtë rast Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtës ka vepruar pajtim më nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke e shpallur të njëjtën si kandidat fitues.

Përmbledhur si me sipër, e duke bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1124/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, N.Sh;
- Ministrinë e Mbrojtës: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Departamenti për Politika të Personelit dhe Rekrutimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.